

UDHËZIM
Nr.13/1, datë 8.9.2010

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË UDHËZIMIN NR.6257, DATË 2.9.2008
“MBI PËRCAKTIMIN E MASËS SË SUBVENCIONIT PËR FAMILJET QË
PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, të ndryshuar, dhe bazuar në pikat 3 e 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 5, germa (a), në fund të fjalisë shtohet paragrafi:

“ose banojnë nën normat e strehimit, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.814, datë 3.12.2004”

1. Pas pikës 7/5 shtohet pika 7/6 me këtë përmbajtje:

“7/6. Familja qiramarrëse në ish-pronë private detyrohet të lirojë banesën e pronarit brenda 30 ditëve nga data e lëvrimit të kredisë”.

3. Pas pikës 21, shtohet pika 22 me këtë përmbajtje:

“22.Transferimi nga subjektet përfituese sipas këtij udhëzimi, i kredive të marra për strehim në banka të tjera përpara fillimit të këtij programi, mund të bëhet kur është praktikisht e realizueshme në marrëveshje midis bankës ku është marrë kredia dhe bankës që zbaton programin, vetëm në rastet kur familja plotëson kushtet sipas pikës 5 të këtij udhëzimi dhe kriteret e përcaktuara në pikat 5 e 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”.

Shuma e kredisë për të cilën mund të subvencionohen nuk mund të jetë më e madhe se ajo e përcaktuar në këtë udhëzim dhe në shkresat e institucioneve përkatëse për subjektet që përfitojnë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007.

4. Në të gjithë tekstin e udhëzimit, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit zëvendësohet me Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode